

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-70/1

Në bazë të neneve 14.1 dhe 15.2.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe duke u bazuar në Ligjin nr. 05/L-80 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, pas rekomandimit të Drejtorit të Sekretariatit të Bordit të Drejtorëve për amendamentim të Statutit të Bordit, Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me 30 dhjetor 2015 nxjerr këtë:

V E N D I M


- I. Aprovohet Statuti i Bordit të Drejtorëve të AKP-së i amendamentuar.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 30 / 12 / 2015



Petrit Gashi

Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-70/2

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 30 dhjetor 2015 nxjerr këtë:

V E N D I M


- I. Procesverbali i mbledhjes të Bordit të AKP-së të mbajtur më 26 dhe 31 Gusht 2014 i paraqitur për aprovim, nëpërmjet kësaj njihet si procesverbal zyrtar dhe final i mbledhjes të Bordit të cekur më lartë, duke u bazuar në konfirmimin me shkrim të nënshkruar nga pesë anëtarët e Bordit të pranishëm në atë mbledhje.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 30 / 12 / 2015



Petrit Gashi

Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-70/3

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 dhe në bazë të Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre Nr. 04/L-035, pas diskutimeve lidhur me çështjet e "Trepça-Ndërmarrje në Administrim të AKP-së" sipas propozimit të Menaxhmentit të Agjencisë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 30 dhjetor 2015 nxjerr këtë:


V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Menaxhmentit në Mitrovicë të "Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP" për lejim të përmbushjes së kontratave të lidhura me blerësit e koncentratit, duke lejuar vazhdimin e shitjes së pjesës së mbetur të koncentratit të Plumbit dhe Zinkut në bazë të Kontratave në fuqi, respektivisht:
 1. Kontrata Nr. TR-03/2015-P e lidhur me datën 25 shtator 2015 me Kompaninë KCM AD, me seli në Assenvgradsko Shosse, 4009 Plovdiv, Bullgari, për shitje të rreth 11,500 tonëve të koncentratit të Plumbit deri me 31 dhjetor 2016.
 2. Kontrata Nr. TR-04/2015-Z e lidhur me datën 23 shtator 2015 me Kompaninë Sara International Pvt. Ltd me seli në A-31, Hauz Khaz, New Delhi 110013, Indi, për shitje të rreth 15,000 tonëve të koncentratit të Zinkut deri me 31 dhjetor 2016.
- II. Aprovohet kërkesa e Menaxhmentit në Zveqan të "Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP" për lejim të përmbushjes së kontratave të lidhura me Blerësit e Koncentratit, duke lejuar vazhdimin e shitjes së pjesës së mbetur të koncentratit të Plumbit dhe Zinkut në bazë të Kontratave në fuqi, respektivisht:
 1. Kontrata Nr. S/1 e lidhur me datën 22 prill 2015 me Kompaninë ZGH Boleslaw S.A ul. Kolejowa 37, Pl 32-332 me seli në Bukowno, Poloni për shitje të 10,000 (+/-10%) tonëve të koncentratit të Zn.
 2. Kontrata Nr. S/2 e lidhur me datën 19 maj 2015 me Kompaninë Mineco Internacional Limited, me seli në Laser House, 132-140 Goswell Road, EC1 V7DY Londer, Angli për shitje të 12,000 tonëve të koncentratit të Pb.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 30 / 12 / 2015



Petrit Gashi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-70/4

Në bazë të nenit 15 paragrafi 2.7 dhe nenit 19 paragrafi 3.3 dhe 3.4 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për bartjen e fondeve teprice në buxhetin e Qeverisë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 30 dhjetor 2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Menaxhmentit të AKP-së që të ardhurat e identifikuara si Fonde Teprice sipas nenit 19, paragrafi 3.3 të Ligjit të AKP-së nga 125 NSH-të e paraqitura në listën e bashkangjitur si Shtojca 1, në shumën totale prej €61,310,628 të barten në llogarinë "AKP Fondet teprice te likuidimit" me numër 1000400070005224 të Qeverisë së Kosovës në Bankën Qendrore të Kosovës.
- II. Udhëzohet Kryesuesi i Bordit të AKP-së që të njoftojë Kryetarin Kuvendit të Kosovës, Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrin e Financave me vendimin e aprovuar dhe njëkohësisht t'i informojë se sipas nenit 19.3.4 të Ligjit, në rast se shuma e mbetur në një fond të mirëbesimit nga i cili janë transferuar Fondet Teprice në Qeveri sipas nenit 19 paragrafi 3.3. është e pamjaftueshme për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme, AKP-ja e njofton Qeverinë për këtë dhe Qeveria menjëherë do t'i kthejë fondet përkatëse në fondin e mirëbesimit nga i cili janë transferuar.
- III. Lista e këtyre Ndërmarrjeve është bashkangjitur në këtë vendim si *Shtojca 1*.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 30 / 12 / 2015



Petrit Gashi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit